



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058390

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05397003

KPPP.nr.1318/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “VTD” SH.P.K., me NUI: 810869943, me seli në rr. “Ismail Qemali”, Nr. 2, në Pejë, kundër debitorit “BS” SH.P.K., me NUI: 810023739, me seli në rr. “Vëllezërit Dragaj” në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.A., avokat nga Vushtrria, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.81/23 të datës 11.07.2023, të Përmbartuesit Privat Zija Bala me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 29.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “BS” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.81/23 të datës 11.07.2023, të Përmbartuesit Privat Zija Bala.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.81/23 të datës 11.07.2023, të Përmbartuesit Privat Zija Bala.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “VTD” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.81/23 të datës 11.07.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 23-3V01-000070 të datës 14.06.2023; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, në emër të borxhit lëndor t’ia paguaj kreditorit shumën prej 77,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, që do të krijohen, ashtu që të gjitha detyrimet të

realizohen përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe përmes regjistrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar ndër të tjerash se fatura e lartcekur është paguar tek personi përgjegjës i kreditorit, por që i njëjti nuk i ka dorëzuar mjetet materiale tek punëdhënësi i tij, ndërsa debitori posedon faturat me të cilat detyrimi është përmbushur në tërësi. Më tutje ka shtuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është marrë urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbarim dhe të detyrohet kreditori që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se debitori nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme me të cilën e dëshmon pagesën e mjeteve monetare dhe se personi i apostrofuuar nga debitori si pranues i mjeteve nuk ka kompetencë për pranimin e mjeteve dhe pagesave nga debitori. Më tutje ka shtuar se në faturë është përcaktuar qartë mënyra dhe koha e pagesës së mjeteve, ku pagesa është përcaktuar të bëhet në llogaritë bankare të kreditorit dhe atë brenda afatit prej 5 ditësh nga dita e pranimit. Në fund ka theksuar se fatura në rastin konkret është pranuar, vulosur dhe nënshkruar nga debitori, ashtu që është në harmoni me të gjitha dispozitat ligjore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 23-3V01-000070 e datës 14.06.2023 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 23-3V01-000070 të datës 14.06.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin dhe vulën nga ana e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit, se në rastin konkret ka paguar detyrimin sipas faturave kontestuese, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se debitori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi përmes së cilës do të mund të vërtetohej një fakt i tillë, edhe pse i njëjti e ka pasur detyrim që prapësimin të ia bashkëngjis provat me shkrim siç përcaktohet në dispozitën e nenit 69 par.4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1318/23, datë 29.02.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.